

Defragmentimi i diskut

Defragmentimi i diskut

Në rreshtat që do të pasojnë më poshtë ju do të mësoni si të defragmentoni diskut.

Por sëpari le të shohim njëherë se çka është defragmentimi dhe pse duhet ta defragmentojmë diskut e fortë?

Në kompjuterin tuaj, ju pothuajse çdo ditë krijoni, skedar të rinjë, folldera të rinjë, fshini ndonjë skedar apo follder të cilët nuk ju nevojiten më; instaloni ndonjë program (softuer) të ri, apo deinstaloni ndonjë tjetër; apo edhe shkarkoni ndonjë skedar nga interneti. Por çfarë ndodhë gjatë këtyre veprimeve tuaja?

Çdo skedar që krijohet në hard disk, vendoset në një vend të caktuar në të. Kështu ju keni krijuar një skedar të ri dhe ndoshta keni fshirë ndonjë tjetër nga hard disku i kompjuterit tuaj, ku në te cilin janë krijuar edhe hapësira të zbrazëta me madhësi të ndryshme.

Si janë krijuar këto zbrazëtira?

Kur keni krijuar ndonjë skedar me madhësi më të madhe se sa ka pasur vend në një hapsirë të caktuar, ai një pjesë e ka vendosë në hapsirën që së pari e ka gjetë të lirë dhe pastaj ka kërkuar vend të lirë dikund tjetër. Kjo do të thotë se skedari që ju keni krijuar është vendosur në dy apo më shumë vende të hard diskut tuaj.

…

Dhe çka pason pas kësaj?

Ju do të shihni se kompjuteri juaj nuk do të punoj ashtu si më pare, dhe ju filloni të mendoni se kompjuteri juaj nuk është në rregull, sepse ndodhë edhe të paraqiten probleme të ndryshme, sipsh bllokimi i programeve kur ju jeni duke punuar, pastaj kur dëshironi të hapni një program ju duhet të prisni disa minuta që ai të aktivizohet, etj.

Çka duhet të bëjmë tani?

Asgjë të jashtëzakonshme, të gjithë nga ju mund ta beni, nuk duhen njohuri të mëdha. Krejt çka duhet të bëni është t'i ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Start,
2. All Programs,
3. Accessories,
4. System Tools,
5. Disk Defragmenter.

Preferohet që cdo muaj të defragmentohet disku.